REPUBLIKA E SHQIPERISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI CIVIL

Nr. 11243-03587-00-2015 i Regj. Themeltar
Nr. 00-2015-4263 i Vendimit (504)

V E N D I M

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i përberë nga:

Majlinda ANDREA Kryesues
Shkëlzen SELIMI Anëtar
Admir THANZA Anëtar

Në seancën gjyqësore të datës 09.12.2015, mori në shqyrtim çështjen civile me nr.11243-03587-00-2015 që u përket palëve:

PADITËS: **SHOQËRIA "DARDANIA NDËRTIM" SH.P.K,** *e përfaqësuar në gjykim nga avokate Irena Reso me autorizim të administratorit të paditësit datë 09.04.2015.*

I PADITUR: **SHOQËRIA "TEODORI 2003" SH.P.K,** *e përfaqësuar në gjykim nga avokati Sokol Lamaj me autorizim të administratorit të padituri datë 08.04.2015.*

OBJEKTI: *Detyrimi i palës së paditur të përmbushi detyrimin në shumën prej 18.000 Euro, ndaj Shoqërisë "Dardania Ndërtim" Sh.p.k., të faturave të pashlyera të "Shërbimeve topografike". Sigurimin e padisë duke vendosur sekuestro konservative mbi llogaritë bankare të padituri në të gjitha bankat e nivelit të dytë në shumën 18.000 Euro.*

BAZA LIGJORE: *Nenet 32, 153, 202 e vijues te K. Pr. Civile. Nenet 420, 422, 445, 850 e vijues të K.Civil.*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin Nr.s'ka, datë 15.09.2015, ka vendosur:

- *Rrëzimin e kërkesës për nxjerrjen e çështjes civile me Nr.6048 Akti, jashtë juridiksionit gjyqësor.*

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim në Gjykatën e Lartë pala e padituri Shoqëria "Teodori 2003" Sh.p.k., me datë 18.09.2015, duke kërkuar nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit për këto shkaqe:

- *Marrëdhënia e detyrimit ka lindur si rezultat i të vetmes kontratë të krijuar midis palëve ndërgjyqëse, atë të datës 5 mars 2012 me objekt "Prokurimi, instalimi dhe dorëzimi i punimeve të ndërtimit" të ndryshuar.*
- *Në nenin 18 me titull "Ligji në fuqi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve është parashikuar: "Çdo mosmarrëveshje, polemikë ose pretendim që lind nga ose në lidhje me kontratën, e cila nuk mund të zgjidhet nga palët, do të dërgohet për arbitrazh në përputhje me rregullat e pajtimit dhe të arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë të Shqipërisë nga një (1) arbitër i caktuar nga organi kompetent i Dhomës. Procedura e arbitrazhit do të zhvillohet në gjuhën angleze. Vlerësimi i dhënë nga arbitri do të jetë përfundimtar dhe detyrues për të dyja Palët. Në rastin e një mosmarrëveshje të tillë, kundërshtie apo pretendimi, Kontraktuesi do të vazhdojë të kryejë punimet në përputhje me udhëzimet e Punëdhënësit.*
- *Në të tilla rrethana detyrimi i gjykatës për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit kur ka një marrëveshje arbitrazhi buron nga Konventa e New Jorkut për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr .8688, datë 20.11.2000. Neni 18 i kontratës përbën një klauzolë arbitrazhi në kuptim të kësaj konvente dhe rrjedhimisht është e detyrueshme për tu njohur nga gjykatat.*

KOLEGJI CIVIL I GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjoi relacionin e gjyqtarit Admir Thanza; përfaqësuesin e palës së paditur Shoqëria "TEODORI 2003" SH.P.K, av. Sokol Lamaj, i cili përfundimisht kërkoi nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit të Gjykatave Shqiptare; përfaqësuesit e palës paditëse Shoqëria "DARDANIA NDËRTIM" SH.P.K, av.Irena Reso, e cila përfundimisht kërkoi, lënien në fuqi të vendimit nr. s'ka, datë 15.09.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, si diskutoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

I. Rrethanat e çështjes

1. Paditësi, Shoqëria "DARDANIA NDËRTIM" SH.P.K, është një shoqëri shqiptare e regjistruar si person juridik që prej datës 18.03.2011, me objekt të veprimtarisë së saj tregtare *ndërtim, projektim, menaxhim dhe konsulentë teknike në fushën e telekomunikacioneve, elektrike, elektronike, teknologjisë, ndërtimit dhe pjesëve të ndërrimit etj*, referuar ekstraktit të QKR-së.
2. Nga ana tjetër i padituri Shoqëria "TEODORI 2003" SH.P.K, është gjithashtu një shoqëri shqiptare e regjistruar si person juridik që prej datës 09.09.2004, me objekt të veprimtarisë së saj tregtare *ndërtimi i hidrocentraleve Ternovë dhe Zalli Bulqizë, sipas parametrave të përcaktuar në marrëveshjen e miratuar me VKM nr.556, datë 1.8.2003, të ndryshuar, si dhe shfrytëzimit optimal tekniko-ekonomik për prodhimin e energjisë elektrike*, referuar ekstraktit të QKR-së.
3. Sipas akteve të administruara në gjykim në shkallë të parë, Urdhër Prokurimi, datë 11 dhjetor 2012, ka rezultuar së pala paditëse Shoqëria "DARDANIA NDËRTIM" SH.P.K, i shet palës së paditur Shoqëria "TEODORI 2003" SH.P.K, punën e titulluar

në këtë urdhër "Punime topografike në terren" në vlerën 18.000 Euro *(përfshirë T.V.SH).*

4. Në kushtet e veçanta sipas këtij urdhër prokurimi rezulton se çmimi total është *lump sum.* Gjithashtu kontraktori është përgjegjës për të gjitha pajisjet, transportin, fuqinë punëtore dhe të gjitha materialet e tjera të nevojshme për të përmbushur shërbimin e përshkruar në këtë urdhër prokurimi.
5. Paditësi ka pretenduar se ka përmbushur detyrimin sa sipër, duke nxjerrë dhe faturën tatimore të shitjes me nr.86239906, datë 10.10.2014 për shërbimin topografik për Zall Bulqizë në vlerën e përcaktuar në urdhër prokurimi *(e pa nënshkruar nga i padituri në cilësinë e blerësit të shërbimit).*
6. Në rrethanat kur i padituri nuk ka paguar vlerën e shërbimit të ofruar të përcaktuar në urdhër prokurimin dhe faturën tatimore të shitjes me nr.86239906, datë 10.10.2014, paditësi i është drejtuar gjykatës me padinë me palët ndërgjyqëse, objektin dhe bazën ligjore të përcaktuar në pjesën hyrëse të vendimit.
7. Në seancën gjyqësore të datës 13.07.2015, përfaqësuesi i të paditurit i ka kërkuar gjykatës nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, duke pretenduar se:
   Marrëdhënia e detyrimit ka lindur si rezultat i të vetmes marrëdhënie kontraktore të krijuar ndërmjet palëve ndërgjyqëse me kontratën e datës 5 mars 2012 me objekt: "Prokurimi, instalimi dhe dorëzimi i punimeve të ndërtimit" e ndryshuar.
   Në nenin 18 të Kontratës "Ligji në fuqi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve është parashikuar: "Çdo mosmarrëveshje, polemikë ose pretendim që lind nga ose në lidhje me kontratën, e cila nuk mund të zgjidhet nga palët, do të dërgohet për arbitrazh në përputhje me rregullat e pajtimit dhe të arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë të Shqipërisë nga një (1) arbitër i caktuar nga organi kompetent i Dhomës. Procedura e arbitrazhit do të zhvillohet në gjuhën angleze. Vlerësimi i dhënë nga arbitri do të jetë përfundimtar dhe detyrues për të dyja Palët. Në rastin e një mosmarrëveshje të tillë, kundërshtie apo pretendimi, Kontraktuesi do të vazhdojë të kryejë punimet në përputhje me udhëzimet e Punëdhënësit.
   Në bazë të nenit 414 të K.Pr.Civile ekzistenca e një marrëveshje arbitrazhi, bën që gjykatat të mos kenë juridiksion në shqyrtimin e mosmarrëveshjes, objekt i mosmarrëveshjes së arbitrazhit.
   Nxjerrja e çështjes jashtë juridiksionit buron dhe nga Konventa e New Jorkut për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë.
8. Lidhur me kërkesën sa sipër pala paditëse ka prapësuar:
   Kontrata objekt gjykimi ka për objekt kryerjen e punimeve topografike në terren, projekti Zall Bulqizë.
   Kontrata e datës 05.03.2012 pretenduar nga i padituri është me objekt krejt të ndryshëm nga objekti i gjykimit, konkretisht është një kontratë sipërmarrje.
9. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë,** me vendimin Nr.s'ka, datë 15.09.2015, ka vendosur:
   Rrëzimin e kërkesës për nxjerrjen e çështjes civile me Nr.6048 Akti, jashtë juridiksionit gjyqësor.
10. **Gjykata** në këtë vendim përgjithësisht ka arsyetuar se ndërmjet palëve ndërgjyqëse ekziston dhe një marrëdhënie tjetër detyrimi, e cila nuk është objekt i këtij konflikti gjyqësor dhe konkretisht kontrata e datës 05.03.2012 me objekt, *Prokurimi, instalimi, komisonimi i punimeve në rrjedhën e sipërme 8.3 Ternovë, Shqipëri. (Projekti i hidrocentralit të vogël Ternovë) me vlerë të kontratës 3.310.098 Euro pa TVSH.* Në të gjashtë seksionet e kontratës në asnjë prej tyre nuk rezulton të jetë pasqyruar pretendimi i të paditurve se kontrata e datës 11.12.2012 "*Për punimet topografike në*

Zall Bulqizë" të jetë apendiks i kontratës së datës 05.03.2012. Në të tilla rrethana, duke qenë para dy kontratave të ndryshme vullneti i palëve sipas nenit 18 të kontratës së datës 05.03.2012 me objekt, *Prokurimi, instalimi, komisonimi i punimeve në rrjedhën e sipërme 8.3 Ternovë, Shqipëri. (Projekti i hidrocentralit të vogël Ternovë)* për të zgjidhur cështjen në arbitrazh nuk sjell efekte për marrëdhënien objekt gjykimi. Në të tilla rrethana për gjykatën nuk ka vend të analizojë vlefshmërinë e klauzolës së arbitrazhit sipas nenit 18 të kontratës së datës 05.03.2012 sipas përcaktimeve të nenit 404 të K.Pr.Civile, apo detyrimeve që burojnë nga Konventa e New Jorkut "Për njohjen dhe ekzekutimin e Vendimeve të Huaja në Arbitrazh.", për shkak se ajo nuk shtrin efektet në marrëdhënien objekt gjykimi.

11. Kundër vendimit nr.s'ka, datë 15.09.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka paraqitur rekurs **i padituri Shoqëria "TEODORI 2003" SH.P.K**, me shkaqet e lartëpërmëndura.

II. Ligji i zbatueshëm:

12. Kodi i Procedurës Civile i cili parashikon që :

12.1. **Neni 14 i K.Pr.Civile**: *"Gjykata ka për detyrë që të zhvillojë një proces të rregullt ligjor, nëpërmjet garantimit të zhvillimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, në përputhje me ligjin"*.

12.2. **Neni 16§1 i K.Pr.Civile**:*"Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj. Ajo bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët"*.

12.3. **Neni 59 i K.Pr.Civile**: *" Gjykata në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit, qoftë edhe kryesisht, merr në shqyrtim nëse çështja që shqyrton, bën pjesë në juridiksionin gjyqësor apo atë administrativ. Kundër vendimit të dhënë për një rast të tillë, mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Lartë"*.

12.4. **Neni 404 i K.Pr.Civile**: Pavlefshmëria e marrëveshjes për arbitrazh.*" Është i pavlefshëm kushti për gjykimin e mosmarrëveshjes me arbitrazh, kur nuk pasqyrohet me shkrim në vet marrëveshjen kryesore të palëve ose me një dokument tjetër të shkruar që i referohet asaj, siç mund të jetë telegrami, teleksi e çdo mjet tjetër i saktë që përbën provë shkresore. Marrëveshja e palëve, sipas paragrafit të parë, është e pavlefshme, në rast se në atë nuk parashikohet mënyra e caktimit të arbitrit ose arbitrave, si dhe objekti i mosmarrëveshjes, kur ajo efektivisht ka lindur. Marrëveshja për gjykimin me procedurë arbitrazhi shfuqizohet, kur një arbitër i caktuar sipas kësaj procedure nuk pranon misionin e besuar.*

III. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vlerëson se:

13. Vendimi nr. ska, datë 15.09.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është marrë në zbatim të drejtë të ligjit procedural dhe si i tillë ai duhet të lihet në fuqi.
14. Ky Kolegj vlerëson se *ankimi i veçantë* i paraqitur nga **i padituri Shoqëria "TEODORI 2003" SH.P.K**, nuk përmban shkaqe ligjore nga ato të parashikuara në nenin 472 të K.Pr.Civile, të cilat e bëjnë të cenueshëm vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
15. Ky Kolegj çmon se çështja e juridiksionit është një nga çështjet më të rëndësishme procedurale, mosrespektimi dhe moszgjidhja drejt e së cilës sjell automatikisht

prishjen e vendimit. Përcaktimi i saktë i juridiksionit, pra nëse çështja hyn në juridiksionin gjyqësor apo në ndonjë juridiksion tjetër (siç është pretendimi në rastin konkret që mosmarrëveshja duhet t'i nënshtrohet procedurës së arbitrazhit), ka rëndësi të madhe për vetë fatet e çështjes dhe për zgjidhjen përfundimtare të saj. Kjo është dhe arsyeja se përse Kodi i Procedurës Civile mungesën e juridiksionit gjyqësor e ka konsideruar si një nga shkeljet më të rënda të normave procedurale, gjë që sjell si pasojë prishjen e vendimit nga gjykatat më të larta (neni 472, pika (b) në referencë të nenit 467).

16. Në nenin 59 të K.Pr.Civile, parashikohet shprehimisht se: "*Gjykata në çdo fazë dhe shkallë gjykimi, qoftë edhe kryesisht, merr në shqyrtim nëse çështja që shqyrton bën pjesë në juridiksionin gjyqësor apo administrativ. Kundër vendimit të dhënë për një rast të tillë, mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Lartë*".
17. Në analizë të dispozitës së mësipërme konstatohet se çështja e juridiksionit mund të jetë objekt shqyrtimi gjyqësor nga çdo gjykatë e pushtetit gjyqësor dhe në çdo fazë gjykimi. Çdo lloj gjykate dhe në çdo shkallë gjykimi ka të drejtë të marrë në shqyrtim, të analizojë dhe të vendosë nëse çështja është në juridiksionin gjyqësor, nëse është në juridiksionin administrativ, nëse është në juridiksionin kushtetues, nëse duhet të gjykohet nga gjykata e arbitrazhit, nëse subjekti kërkues është një subjekt i huaj, i cili gëzon imunitet diplomatik, etj.
18. Këtë gjë gjykata mund ta bëjë *edhe kryesisht*, pra dhe pa u pretenduar nga palët dhe kjo pasi çështja e juridiksionit është e lidhur ngushtë me elementet që përbëjnë administrimin e procesit gjyqësor, si dhe me të drejtën për një proces të rregullt ligjor të sanksionuar në nenin 6 të KEDNJ.
19. Në këto kushte, sa herë që çështja e juridiksionit bëhet objekt shqyrtimi gjyqësor, fati i procesit gjyqësor do të varet nga vendimi që merr Gjykata e Lartë në fund të shqyrtimit të kësaj çështje. Në nenin 59, pika 2 të K.Pr.Civile është parashikuar shprehimisht se: *"Kundër vendimit të dhënë për një rast të tillë mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Lartë"*.
20. Vetëm vendimi i Gjykatës së Lartë, i cili pranon ekzistencën e juridiksionit gjyqësor gjatë shqyrtimit të një çështje, i hap rrugë shqyrtimit të çështjes, pa paragjykuar në asnjë rast themelin e saj. Në këto kushte *"Gjykimi i filluar pezullohet derisa të jepet vendimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes për juridiksionin. Gjykata mund të marrë vetëm masa për sigurimin e padisë dhe të kryejë veprime procedurale që nuk presin"* (neni 60, pika 2 i K.Pr.Civile).
21. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vlerëson se pavarësisht se këto dispozita flasin për konfliktin midis juridiksionit administrativ dhe atë gjyqësor, i njëjti parim respektohet dhe në rastin e konfliktit që mund të ekzistojë midis juridiksionit gjyqësor dhe juridiksionit të gjykatave të arbitrazhit, nga ana e gjykatës së arbitrazhit, apo nga organet gjyqësore të zakonshme.
22. Domosdoshmëria e zgjidhjes së këtij konflikti nga Gjykata e Lartë vjen pasi klauzola e arbitrazhit e rënë dakord mes palëve bën që pushteti gjyqësor të mos ketë juridiksion për shqyrtimin e mosmarrëveshjes, *me përjashtim të rastit kur kjo marrëveshje është e pavlefshme.*
23. Kolegji vlerëson të theksojë se, shprehja e vullnetit të palëve për t'iu drejtuar procedurës së arbitrazhit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të thotë në të njëjtën kohë dhe heqje dorë nga procedura e zakonshme e gjykimit, e cila kjo e fundit realizohet nga organet gjyqësore nëpërmjet ngritjes së padisë. Interesi i palëve për t'ja nënshtruar gjykimin e mosmarrëveshjeve arbitrazhit, bëhet pasi ato besojnë se procedura e arbitrazhit ofron për një zgjidhje më të shpejtë të problemeve të krijuara, më efektive dhe më pak të kushtueshme, në të kundërt sa rezulton në këtë gjykim kur

referuar pretendimeve të palëve ndërgjyqëse duhet të hetohet lidhur me punimet e kryera në territorin shqiptar dhe që mund e duhet të zgjidhet vetëm nga gjykata shqiptare.

24. Në rastin objekt gjykimi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë mbi kërkesë të palës së paditur, Shoqëria "TEODORI 2003" SH.P.K, ka marrë në shqyrtim pretendimin nëse kjo çështje bën pjesë në juridiksionin gjyqësor apo duhet referuar në arbitrazh në përputhje me parashikimet e pretenduara nga kjo palë në kontratën e datës 5 mars 2012 me objekt*: "Prokurimi, instalimi dhe dorëzimi i punimeve të ndërtimit" e ndryshuar,* në të cilën në nenin 18 është parashikuar: *"Çdo mosmarrëveshje, polemikë ose pretendim që lind nga ose në lidhje me kontratën, e cila nuk mund të zgjidhet nga palët, do të dërgohet për arbitrazh në përputhje me rregullat e pajtimit dhe të arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë të Shqipërisë nga një (1) arbitër i caktuar nga organi kompetent i Dhomës. Procedura e arbitrazhit do të zhvillohet në gjuhën angleze. Vlerësimi i dhënë nga arbitri do të jetë përfundimtar dhe detyrues për të dyja Palët. Në rastin e një mosmarrëveshje të tillë, kundërshtie apo pretendimi, Kontraktuesi do të vazhdojë të kryejë punimet në përputhje me udhëzimet e Punëdhënësit.*
25. Ky Kolegj e gjen të mbështetur konkluzionin e kësaj gjykate se çështja nuk duhet të nxirret jashtë juridiksionit gjyqësor, sipas klauzolës së parashikuar në nenin 18 të kontratës së sipërmarrjes *"Prokurimi, instalimi dhe dorëzimi i punimeve të ndërtimit" e ndryshuar* referuar përmbajtjes së kësaj kontrate.
26. Pala paditëse ka pretenduar mospagimin nga pala e paditur të faturës tatimore të shitjes lidhur me zërat e punimeve të kryera të pasqyruara në këto fatura. Në nenin 2 të ligjit nr. Nr.7928, datë 27.4.1995 "*Për tatimin mbi vlerën e shtuar*" parashikohet se: *" Personi juridik a fizik, individ ose çdo person tjetër është person i tatueshëm nëse: a) detyrohet të jetë i regjistruar në bazë të këtij ligji, apo..."*.
27. Nga Fatura Tatimore e Shitjes, datë 10.10.2014, e paraqitur nga pala paditëse me cilësinë e provës rezulton se palët ndërgjyqëse që në këto fatura janë palë kontraktuese, shitës dhe blerës, janë të regjistruar si persona të tatueshëm dhe kanë numrat përkatës të identifikimit si persona të tatueshëm.
28. Në nenin 8 të po këtij ligjit (TVSH) parashikohet se: "*1. Me furnizim mallrash kuptohet kalimi i së drejtës për të zotëruar si pronar pasurinë e luajtshme ose pasurinë e paluajtshme.....*". Pra sipas kuptimit të përcaktuar në këtë ligj në rastin objekt gjykimi pala paditëse pretendon se i ka shitur sipas rastit shërbimet e kryera sipas zërave të punimeve të pasqyruara në urdhër prokurimin palës së paditur.
29. Në referim të ligjit sa sipër, referuar shkakut dhe objektit të padisë në çështjen në gjykim edhe sikur të merret e mirëqenë klauzola e arbitrazhit e parashikuar në nenin 18 të kontratës së sipërmarrjes, ky Kolegj vlerëson se marrëdhënia objekt gjykimi e pretenduar si e lindur me urdhër prokurimin e datës 11.12.2012 "*Për punimet topografike në Zall Bulqizë*" qëndron e mëvehtësuar nga kontrata e datës 5 mars 2012 me objekt: "*Prokurimi, instalimi dhe dorëzimi i punimeve të ndërtimit*" e ndryshuar. Klauzola e arbitrazhit pavarësisht nga vlefshmëria e saj nuk mund ti shtrijë efektet në marrëdhënien objekt gjykimi dhe për rrjedhojë vendimi i gjykatës së shkallës së parë për mosnxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor është i drejtë.
30. Në analizë të sa më sipër, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë arrin në përfundimin se vendimi nr. s'ka, datë datë 15.09.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duhet të lihet në fuqi si vendim i marrë në zbatim të drejtë të ligjit.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbështetur në Nenet 59 dhe 485 të K.Pr.Civile,

V E N D O S I:

Lënien në fuqi të vendimit nr.s'ka, datë 15.09.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Tiranë, më 09.12.2015

A N Ë T A R	**A N Ë T A R**	**K R Y E S U E S E**
Admir THANZA	**Shkëlzen SELIMI**	**Majlinda ANDREA**

Vërtetohet njësia me origjinalin P.Adm.Gjyq. D.Qerimi B.A.